

RRJEDHA E PUNËS 2 – Sistemi dhe struktura

Veprimi 2: krijoni mekanizmat e raportimit të klubit tuaj

Për t'u mundësuar anëtarëve të klubit tuaj sportiv të raportojnë në mënyrë të sigurt, është e rëndësishme të sqarohen opsionet e ndryshme të raportimit.

Shembull i mekanizmave të raportimit për një klub sportiv

1. Opsionet e raportimit të brendshëm (brenda klubit)

- Oficeri i Sigurisë (në shumë raste mjafton të përmendet vetëm Oficeri i Sigurisë në mekanizmat e raportimit të klubit)

Emri: [Emer Mbiemer i Oficerit të Sigurisë]

Adresa e emailit: [Emaili Zyrtar i Oficerit të Sigurisë]

Numri i telefonit: [Numri i telefonit të Oficerit të sigurisë]

Ose mund të kontaktoni Oficerin e Sigurisë gjatë stërvitjes ose garës.

- Trajneri ose përgatitësi:

(Idealisht vetëm nëse trajneri nuk është i përfshirë në incident.)

- Bordi:

Adresa e emailit të bordit: [Adresa zyrtare e bordit]

Raporti do të trajtohet në mënyrë konfidenciale dhe, në shumicën e rasteve, do t'i përcillet Zyrtarit të Sigurisë. Është Zyrtari i Sigurisë ai që do të merret me raportin.

2. Opsionet e raportimit të jashtëm

- Oficeri i Sigurisë i Federatës Sportive

Nëse klubi juaj sportiv është i anëtarësuar në një federatë sportive, ju mund të kontaktoni Oficerin e Sigurisë së Federatës (nëse ka një të tillë), për këshilla, udhëzime dhe referime të mundshme.

Emri: [Emer Mbiemer i Oficerit të Sigurisë]

Adresa e emailit: [Adresa zyrtare e oficerit të sigurisë]

Numri i telefonit: [numri i telefonit zyrtar i oficerit të sigurisë]

- Policia:

Në rast të veprave penale, ju mund të kontaktoni direkt policinë.

Organizata të tjera në vendin tuaj që merren me raportime të dhunës ndërpersonale. Listoni këto organizata dhe përfshijini ato në opsionet e raportimit për anëtarët tuaj.